

	KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
---	---	---

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI - SUHAREKË

Nr. Protokollit	01/ 2026
Vendi i takimit:	Salla e Bordit të Drejtorëve
Datë:	08.04.2026

PROCESVERBAL

Nga takimi i Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive “KKSB” - Suharekë të paraparë sipas Udhëzimit Administrativ të nënshkruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Nr-27/2012, dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Nr-03/2012, për themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Takimi filloi në ora 10.00

Në takim morën pjesë :

Safet Hoxha - Komandant në Stacionin Policor në Therandë

Haki Hoxha - përfaqësues i Komunitetit Islam

Albert Demaj - përfaqësues i Komunitetit Katolik

Amir Hoxha - Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë

Feriz Gega - përfaqësues e EVSB-së

Remzi Bajselmani - Drejtor i Drejtorisë së Arsimit

Habibe Bytyqi - Zyrtare për Barazi Gjinore

Vedat Shatri - përfaqësues i FSK-së

Drilon Zyba - përfaqësues i KLSP-së

Shpëtim Selimi - Kryetar i KPAK-së

Rilind Kuçi - përfaqësuese e OJQ-ve

Refki Zogaj - përfaqësues i Komunitetit të Biznesit

Euro Linda Zenelaj - përfaqësuese e Mediave lokale

Xheladin Sadikaj - përfaqësues i zyrës KKK-së

Luljeta Tafolli - përfaqësuese e KPAK-së

Luljeta Berisha - përfaqësuese e Shqiptarëve

Shkëndije Shabanaj - Kryesues i KK-së dhe përfaqësues i KA-li

Zekë Berisha - përfaqësues i Romëve

Nazim Shabanaj - përfaqësues i Egjiptasve

Mbledhjen e hapi Kryetari I Komunës e cili i njoftoi me rendin e ditës.

Rend dite

- 1. Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në territorin e Komunës së Suharekës;**
- 2. Vetëdijesimi i nxënësve për rrezikun nga minat dhe mjeteve të tjera të pa shpërthyer nga lufta;**
- 3. Identifikimi i hapësirave publike ku cenohet lëvizja e lire e qytetarëve;**
- 4. Trajtimi i qenve endacak;**

Kryetari - përshëndet të pranishmit dhe e hedh në votim rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika1.Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në territorin e Komunës së Suharekës;

Kryetari-ia kalon fjalën komandantit të Policisë

Safet Hoxha-përshendetje për të gjithë,në përgjithësi situata e sigurisë në territorine Komunës së Suharekës është e qetë,në këtë 3 muor tek vjedhjet kemi rënje -11% krahasuar me vitin e kalum,aksidente në këtë 3 muor kemi pas rënje,në përgjithësi dëshmin e veprave penale si stacion e kemi shumë mire dikun 77.2%,vrasje grabitje nuk ka,në përgjithësi e kemi një bashkëpunim të mire në parandalim me DKA-në dhe Shkollat jemi shumë të angazhum në ligjerata me nxënës,I kemi bënë një prezantim të stacionit.Shqetësuese në këtë faze jemi duke pranuar shumë ankesa për çështjen e mbeturinave kjo situatë nëse vazhdon kështu do të kalon në domenin ton dhe të prokurorisë sepse po rrezikohet shëndeti publik po besojë që do të bëhet ndonjë zgjidhje përndryshe duhet me fillu me marrë masa penale sepse ankesat i kemi të përditshme.

Kryetari-ne e kemi bënë një rregullore para 3 vite në bashkëpunim me kompanin japoneze Jica në atë kohë është bënë kërkesë që me u ngritë tarifa në 6€ dhe asnjëherë nuk ka kalu në Asamblenë Komunale.Javëne fundit të këtij muaji është punu një rregullore e re dhe kemi arrit me kalu në Asamble Komunale me tarifë 6€ mirpo sipas raporteve të Kompanisë së Eko-Regjionit humbjet janë shumë më të mëdha dhe nuk kanë mundësi me i plotësu nevojat e punëtorëve,amortizimit dhe pagat e punëtorëve,ata janë duke kërku 7.50€ dhe unë sot kam kërku takim prej shefav të grupeve parlamentar dhe Drejtorit Regjional me bisedu edhe një here për me bënë një zgjidhje sepse gjendja është kaotike.

Refki Zogaj-kemi ankesa sa i përket komunitetit të bizneseve në Zonën Industriale e kanë bënë një rritje enorme për arsye nga 11€ në 70€ në muaj dhe ne kërkojmë klasifikim nga ai biznes që gjeneron më pak mbeturina psh vetëm një shportë nga ai më shumë 4-5 sepse po na sjellë shumë pa kënaqësi.

Habibe Bytyçi-përshendetje për të gjithë,falenderojë Komandantin për informacionet që na dha,vetëm kisha dashtë me dit prej Komandantit sa kemi pas këtë 3 muor raste të dhunës në familje.

Safet Hoxha-në këtë 3 muor i kemi 19 raste.

Avni Bytyçi-fal bashkëpunimit të Komunës,qytetarëve dhe të Policisë veq ka fillu trendi I rënjeve të veprave të ndryshme që jan të sangsionume me ligj

Rekomandim- Të vazhdohet bashkëpunimi mes policisë,komunës dhe qytetarëve me qëllim të eliminimit të dukurive negative në territorin e Komunës së Suharekës.

Kryetari- e hedh në votim rekomandimin.

Aprovohet rekomandimi

Pika 2. Vetëdijesimi i nxënësve për rrezikun nga minat dhe mjeteve të tjera të pa shpërthyer nga lufta;

Remzi Bajselmani-Përshendetje për të gjithë,kjo është një ndër pikat që është diskutu në vazhdimësi për qdo periudhë të pranverës me qëllim që të bëhet vetëdijesimi i nxënësve veqanarisht në 3 Shkollat e mesme ku ata jan me të vetdijëshem dhe frekuentojnë ambiente të ndryshme për këtë kemi pas bashkëpunim të vazhdueshëm me FSK-ën dhe me Policin e Kosovës të cilët kan mbajtë ligjerata informuese.

Rekomandim-DKA të përgadit orarin dhe të bën kërkesë në FSK,ekipa e specializuar që është për çështjen e trajnimeve mbajtjen e ligjeratave për nxënësit e Shkollave të Mesme aty ku e vlerëson dhe e konsideron Dka që është e nevojshme të mbahen këto ligjerata dhe ta adreson kërkesën tek organi kompetent që të fillon procedurat para se me përfundu viti shkollor.

Kryetari-e hedhë në votim rekomandimin

Aprovohet rekomandimi

Pika 3.Identifikimi i hapësirave publike ku cenohet lëvizja e lire e qytetarëve;

Kryetari-te sheshi 1 dhe sheshi 2 të lirohen hapësirat publike sidomos shiriti për persona me nevoja të veqanta .

Safet Hoxha-do ta marrim parasysh këtë çështje q të lirohet shiritit për persona të verbër dhe do të ketë prezencë më të madhe të Policis aty.

Rekomandim:të lirohen të gjitha hapsirat publike me theks të veqant siq e përmendi Kryetari dy sheshet dhe trotualet në rrugen Xhavit Sylaj,Skënderbeu dhe Brigada 123 të jet e lir për lëvizjen e qytetarëve.

Kryetari- e hedhë në votim

Aprovohet rekomandimi

Pika 4. Trajtimi i qenve endacak;

Kryetari-është problem në tër Kosovën për kundër që në të kalumen jemi mundu me ba zgjidhje me siguru një prone për strehim por nuk ka funksionu përshkak të koston së lart financiare.

Safet Hoxha –në vitin 2024 i kemi pas 13 incidente me qenë 7 kan qenë në njerëz dhe 6 të tjerë në kafshë,1 prej tyre rasteve ka përfundu në rast penal sepse ka qenë qeni privat i dikujt,këtë vit

kemi vetëm dy ankesa për prezencen e qenëve endacak por nuk kemi ndonjë incident kjo është gjendja aktuale.

Remzi Bajselmani-po thuhet në një form që ne nuk kemi qka me ba dhe nuk guxojm,nuk mundemi me ra si institucione veqanarisht afer Shkollave para kësaj sítuate,ne duhet me i pas organet tona shumë aktive që mos me ardh deri te incidenti sepse pasi që po ndodh po gjendet zgjidhje dhe me i largu nga vendet ku frekuentohen shumë nga njerëzit e veqanarisht nxënësit e Shkollave.

Takimi përfundoi:10:40